

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR

PËR PARANDALIMIN NDJEKJEN DHE MARRJEN E MASAVE NDAJ KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE KRIMEVE TË RËNDA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Kreu i I

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton masat që merren nga Policia e Shtetit, procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e tyre, ndaj subjekteve të këtij ligji, të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, terrorizmin dhe krimet e rënda.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi, zbulimi, identifikimi, dokumentimi me qëllim goditjen e organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, si dhe çdo grup tjetër kriminal, me synim konsolidimin e sigurisë në vend, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve e nivelit të punës parandaluese e gjurmuese për zbulimin e gjurmimin e krimin të organizuar, terrorizmin e krimet e rënda.

Nenin 3/1

Përkufizime

Në përmbajtje të këtij ligji, temat e mëposhteme do të kuptohen:

1. "Parandalim" nënkuptohet zhvillimi i linjave strategjike të nevojshme (Nmarja e masave) për të zbuluar dhe ndaluar shfaqjen, zhvillimin dhe shtrirjen e krimin të organizuar, ardhjen e mëtejshme të pasojave.
2. "Përndjekje/gjurmim" është aktiviteti policor që përcakton linjat strategjike për zbulimin dhe identifikimin e autorëve të krimin të organizuar, terrorizmit e krimeve të

rënda, e cila kryhet në mënyrë të planifikuar, organizuar dhe masa operative me synim dokumentimin ligjor të veprimita së kriminale.

3. Krimi i organizuar është veprimtaria kriminale që përmban këta elementë:
- Bashkëpunim i më shumë se dy personave.
 - Ndarje specifike e detyrave.
 - Veprimtari e zgjatur apo e papërcaktuar në kohë.
 - Përdorim i ndonjë lloji disipline apo kontrolli të brendshëm
 - Kryerja Krimesh të Rënda.
 - Shtirje e aktivitetit në rrafsh ndërkombëtar.
 - Përdorim i dhunës.
 - Përdorim i strukturave ekonomike ose tregtare.
 - Përfshirje në Pastim Kapitalesh.
 - Përdorim i influencës rbi politikanë, mas media, administratë publike, autoritete gjyqësore apo aktivitete ekonomike (korupsion).
 - Kërkim për përfitime apo pushtet

Që një organizatë e mirëfilltë kriminale të klasifikohet në kategorië "Grup i Organizuar Kriminal) duhet detyrimisht të plotësojë indikatorët a, c, e, dhe k, dhe përveç tyre, dy të tjerë të çfarëdoshëm.

4. Masat e veçanta policore janë ato veprime që u lejohen forcave të policisë me ligj, për të realizuar parandalimin e krimt të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të rënda, si nevojë e një reagimi të shpejtë, të fshehtë e efikas për të siguruar informacion, identifikuar autorët zbuluar mënyrën e veprimit (modus operanti) dhe siguruar prova të nevojshme për fillimin e procedimit penal.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen ndaj personave, për të cilët policia ka dyshime të arësyeshme, për:

- a) Kryerjen e veprave penale sipas neneve 76, 77, 78, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 114/a, 114/b, 117/3, 128/b, 134/3, 135, 136, 138/a, 139, 140, 141, 141/a, 143/a, 143/b, 144, 144/a, 151, 152, 153, 164/a, 164/b, 172, 183, 184, 186, 186/a, 189, 197/a, 202, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234/a, 234/b, 244, 245, 248, 259, 259/a, 260, 265/a, 265/b, 278, 278/a, 282/a, 282/b, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/b, 284/c, 284/ç, 287, 287/b, 288, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328, 328/a, 333, 333/a, 334, e 334/1;

Neni 4 Parimet

Parimet baze për përdorimin e masave policore janë:

- Respektimi i lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut;
- Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i përdorimit të tyre;
- Sekretet i kryerjes së veprimeve;
- Objektiviteti.

Neni 5 Subjektet

1. Subjekte të masave dhe procedurave të cilat parashikohen në këtë ligj do të jenë të gjithë ata për të cilët:
 - a. Ka dyshime se janë të përfshirë në aktivitete me objekt krimim e organizuar, krimet e rënda dhe terrorizmin;
 - b. Ka dyshime se standardi i jetesës nuk është i justifikuar nga burime të ligjshme por nga të ardhura të veprimtarisë së krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit;
 - c. Janë dënuar me vendim të formës së prerë në Republikën e Shqipërisë për vepra penale sipas dispozitës së nenit 3;
 - d. Janë dënuar me vendim të formës së prerë në një shtet të huaj për vepra penale sipas dispozitës së nenit 3 apo të ngjashme me to sipas legjislacionit të huaj;
 - e. Personave të cilët kanë rekorde të mëparshme kriminale dhe për të cilët ka dyshime, se me veprimet ose mosveprimet e tij kanë për qëllim cënimin e sigurisë publike dhe kombëtare, sipas dispozitës së nenit 3;
 - f. Subjektet juridik për të cilët ka dyshime se ndihmojnë, përfitojnë ose financojnë në veprimtarinë e krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit.

Kreu II MASAT PARANDALUESE PERSONALE

Neni 6

Masat dhe procedurat e mbikëqyrjes speciale që ndërmerren nga Policia e Shtetit

1. Nëse subjektet sipas nenit 5 ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk mund t'ju lejohet hyrja dhe kthimi në vendbanim pa iu nënshtuar një verifikimi të hollësishëm nga Policia e Shtetit në pikën e kalimit kufitar;
2. Policia e Shtetit merr dëshminë, administron dhe fillon kryerjen e verifikimeve hetimeve mbi bazën e deklaramit vullnetar të çdo personi i cili paraqitet dhe jep dëshminë, informacion apo të dhëna mbi aktivitetin e subjekteve të këtij ligji;
3. Për të gjithë subjektet e këtij ligji Policia e Shtetit mund ti kërkojë institucioneve kompetente ndalimin e posedimit ose përdorimit, pjesësisht ose plotësisht, të çdo pajisje komunikimi që transmeton radio, radar dhe syze për shikimin e natës, veshje dhe aksesore për mbrojtje balistike individuale, mjete transporti të blinduara ose të modifikuara për të mitur fuqinë e tyre ose aftësinë, ose në çdo rast të dizajnuar për të shmangur kontrollin e policisë, armë dhe riprodhime armësh të çdo lloji, përfshirë lodra që riprodhojnë armë, instrumente të tjera të afta për të spërkatur lëngje imituese ose përzierje të papërshtatshme për të shkaktuar dëme të njerëzit, produkte piroteknike të çdo lloji, si dhe substanca të ndezshme dhe mjete të tjera të përshtatshme që shkaktojnë lëshimin e flakëve, si dhe programet kompjuterike apo mjetet të tjera që shërbejnë për kriptimin e bisedave dhe mesazheve.
4. Për të gjithë subjektet e këtij ligji Policia e Shtetit mund të urdhërojë kufizimin e perimetrit të lëvizjes së tyre, brenda një zone administrimi, qyteti apo qarku të

caktuar në Republikën e Shqipërisë, urdhër i cili duhet të vlefësohet nga Prokuroria/Gjykata brenda 48 orëve.

Neni 7

Masat dhe procedurat e mbikëqyrjes speciale që ndërmerren nga autoritetet e sistemit të drejtësisë

1. Masat e parashikuara në nenin 6 mund të ndërmerren nga Policia e Shtetit edhe me kërkesë të BKH-së, Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (Prefekt/Prokurori/Gjykata të thjeshta të vendbanimit?);
2. Prokurori/Gjykata për qëllime të mbrojtjes së sigurisë publike mund të urdhërojë kufizimin e menjëhershëm të perimetrit të lëvizjes së subjekteve të këtij ligji, brenda një zone administrative, qyteti, bashkie apo qarku të caktuar në Republikën e Shqipërisë.
3. Vendimi i menjëhershëm i autoriteteve sipas pikës 2 të këtij neni duhet të vlerësohet në një seancë dëgjimore nga Gjykata, brenda 30 ditëve, bazuar në prova dhe në prezencë të Prokurorit dhe mbrojtësit ligjor të subjektit;
4. Seanca dëgjimore shtyhet nëse ekziston një pengesë legjitime për subjektin që ka kërkuar të dëgjohet personalisht dhe që nuk është i arrestuar ose i ndaluar në një vend tjetër nga ai në të cilin kryhet seanca dëgjimore si edhe nëse ekziston ndonjë pengesë legjitime e avokatit;
5. Kur Gjykata vlerëson se çështja është komplekse dhe kërkon prova dhe hetim më të thelluar mund të shtyjë afatin e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, që në çdo rast nuk i kalon nëntëdhjetë ditë.
6. Duke marrë parasysh nevojat e mbrojtjes sociale, dhe, veçanërisht, ndalimin e qëndrimit në një ose më shumë zona administrative, qytete, bashki ose rrethe, ose, duke iu referuar subjekteve të këtij ligji Gjykata mund të ndalojë afimin në vende të caktuara, të frekuentuara zakonisht nga të miturit;
7. Nëse masa e detyrimit për të qëndruar në komunën e vendbanimit ose vendbanimit të zakonshëm ose ndalimi i qëndrimit zbatohet, mund të përshkruhet gjithashtu:
 - a) të mos largohet nga shtëpia e zgjedhur pa njoftuar paraprakisht tek autoriteti zyrtar mbikëqyrës;
 - b) t'i raportojë autoriteteve të sigurisë publike përgjegjës për mbikëqyrjen në ditët e caktuara dhe për çdo thirrje apo vizitë të tij.
8. Urdhri gjyqësor përcakton kohëzgjatjen e masës parandaluese e cila nuk mund të jetë më e vogël se një vit ose më shumë se pesë.
9. Urdhri i Gjykatës i komunikohet prokurorit publik, Policisë së Shtetit, subjektit dhe avokatit të tij.

Neni 8

Masat e mbikëqyrjes speciale në kushtet e emergjencës

1. Në rastet e domosdoshmërisë dhe urgjencës, Policia e Shtetit, nëse ka dyshime për zbatimin e masave për parandalimin e mbikëqyrjes speciale dhe detyrimin e qëndrimit në vendbanimit të zakonshëm apo brenda një perimetrit të caktuar, ndaj subjekteve të këtij ligji, mund të urdhërojë tërheqjen e përkohshme të pasaportës dhe pezullimin e vlefshmërisë për çdo dokument tjetër ekuivalent.
2. Tërheqja e përkohshme e pasaportës dhe pezullimi i vlefshmërisë për mërgimin e çdo dokumenti tjetër ekuivalent, i komunikohen menjëherë prokurorit të rrethit,

ku banon personi, i cili, kërkon vlefshmërinë e tij nga Gjykata brenda dyzet e tetë orëve;

3. Tërheqja e pasaportës dhe pezullimi i vlefshmërisë për qëllimet e riatdhesimi i ndonjë dokumenti tjetër ekuivalent pushon të ketë efekt nëse vlefhtësia nuk ndodh në nëntëdhjetë e gjashtë orë pas urdhërimit të masës.

Neni 9 Ankimimi

1. Në përfundim të vlefhtësimit të masave në Gjykatën e Shkallës së Parë, Prokuroria dhe c'do subjekt ndaj të cilit janë aplikuar masat e parashikuara në nenet 6,7 dhe 8 ka të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit;
2. Ankimimi duhet të ushtrohet brenda 10 ditëve nga marrja dijeni dhe nuk do të ketë efekt pezullues;
3. Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë ankimin brenda 30 ditëve dhe seanca nuk mund të jetë publike.
4. Gjykata e Apelit vendos për lënien në fuqi ose shfuqizimin e vendimit kur konstaton se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka qenë kompetente për shqyrtimin e çështjes (sipas Kodit Antimafia);
5. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të ankimuar, gjykata e apelit ngarkon subjektin ankimes për pagimin e kostove gjyqësore.
6. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë për shkelje të ligjit nga prokurori, subjekti dhe avokati i tij brenda dhjetë ditësh dhe nuk ka efekt pezullues.
7. Gjykata e Lartë shqyrton rekursin në dhomën e këshillimit brenda tridhjetë ditëve nga dita e ankimit.
8. Përveç sa parashikohet në këtë ligj, mbi procedurat dhe shqyrtimin e ankesave, zbatohen rregullat e kodit të procedurës penale në lidhje me zbatimin e masave së sigursë.

Neni 10 Ekzekutimi

1. Vendimi për ekzekutimin e masave të mbikëqyrjes speciale i komunikohet për ekzekutim Policisë së Shtetit;
2. Autoriteti lëshues i masës së mbikëqyrjes speciale, kryesisht ose me kërkesë të subjektit mund të revokohet ose lehtësohet, kur shkakut ose rrethanat për të cilën u bazua lëshimi i tij kanë ndryshuar ose nuk ekzistojnë më.
3. Vendimi mund të rëndohet nga autoriteti lëshues për zbatimin e ndalimit ose detyrimit të qëndrimit, kur ka informacion shtesë për kërcënime serioze të rendit dhe sigursë publike ose kur subjekti i mbikëqyrjes speciale ka shkelur vazhdimisht detyrimet në lidhje me masën.
4. Ankimi kundër revokimit ose dispozitës së ndryshimit nuk ka efekt pezullues.

Neni 11 Autorizimi për të lënë vendbanimin apo zonën e përcaktuar

1. Kur për arsye serioze dhe të provuara shëndetësore, subjektet që i nënshtrohen detyrimit të qëndrimit, me kërkesë të tyre, mund të jenë të autorizuar të shkojnë në një vend të veçantë jashtë bashkisë së vendbanimit të caktuar ose të zakonshëm, për qëllime të

kontrolleve shëndetësore dhe kujdesit të domosdoshëm, duke u larguar për një periudhë jo më të gjatë se dhjetë ditë, përveç kohës së nevojshme për udhëtim.

2. Autorizimi mund të jepet, në të njëjtin afat kohor, edhe kur ndodhin arsye serioze dhe të provuara familjare që e bëjnë atë absolutisht të domosdoshëm dhe urgjent largimin nga vendbanimi i detyrueshëm ose i zakonshëm;
3. Kërkesa e subjektit duhet të paraqitet Gjykatës së Shkallës së parë që ka lëshuar vendimin;
4. Gjykata, pasi ka konstatuar vërtetësinë e shkaqeve dhe rrethanave të paraqitura nga subjekti kërkuar, vendos për një urdhër të motivuar.
5. Në rastet e urgjencës absolute, kërkesa mund të paraqitet kryetarit të Gjykatës kompetente i cili mund të autorizojë subjektin të largohet për një periudhë jo më të gjatë se tre ditë, përveç kohës së nevojshme për udhëtim.
6. Vendimet e parashikuara në paragrafët 4 dhe 5 i komunikohen prokurorit dhe subjektit kërkuar, të cilët mund të bëjnë ankesë për shkelje të ligjit. **Ankesa nuk ka asnjë efekt pezullues.**
7. Vendimi gjithashtu i vihet në dispozicion informon Policisë së Shtetit dhe autoriteteve të sigurisë publike që mbikëqyrin subjektin, në mënyrë që të informohen për procedurat, destinacionin dhe itinerarin që duhet të ndjekë subjekti.

Neni 12

Raporti i masës së mbikëqyrjes speciale me ato të sigurisë

1. Kur ndaj subjekteve të këtij ligji janë aplikuar masa të sigurisë personale apo shërbimit të provës, gjatë ekzekutimit të tyre nuk mund të aplikohen masat e mbikëqyrjes speciale.
2. Periudha dhe afatet e masave të sigurisë personale si ndalimi, paraburgimi apo shërbimi i provës nuk përlogariten si afate të mbikëqyrjes speciale.

Neni 13

Data efektive dhe përfundimi i masës së mbikëqyrjes speciale

1. Mbikëqyrja speciale fillon nga dita në të cilën vendimi i komunikohet subjektit dhe përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar në vendim, nëse subjekti i mbikëqyrur nuk ka kryer pengjatë kësaj kohe ndonjë vepër penale.
2. Nëse, gjatë afatit të caktuar, subjekti i mbikëqyrur kryen një krim për të cilin dënohet dhe mbikëqyrja speciale nuk ka pse të pushojë, gjykata vlerëson nëse kryerja e këtij krimi mund të përbëjë një rregues të rrezikut të vazhdueshëm të subjektit dhe në këtë rast në këtë rast afati fillon përsëri nga dita në të cilën komunikohet dënimi.
3. Ekzekutimi i mbikëqyrjes speciale mbetet i pezulluar gjatë kohës në të cilën subjekti i nënshtrohet masës së paraburgimit. Në këtë rast, kohëzgjatja e masës parandaluese vazhdon nga dita në të cilën pushon masa e sigurimit personal.
4. Pas ndërprerjes së gjendjes së paraburgimit, nëse ka zgjatur të paktën dy vjet, gjykata verifikon dhe vendos pasi ka dëgjuar prokurorin mbi rrezikshmërisë shoqërore të subjektit, marrja e informacionit të nevojshëm nga administrata e burgut dhe autoritetet e sigurisë publike.
5. Nëse rreziku shoqëror vazhdon, gjykata lëshon një vendim që urdhëron ekzekutimin e masës parandaluese, afati i së cilës vazhdon nga dita në të cilën vendimi i komunikohet subjektit.
6. Nëse, nga ana tjetër, rreziku shoqëror ka pushuar, gjykata lëshon një vendim që revokon dispozitën për zbatimin e masës parandaluese.

KREU III
MASAT PARANDALUESE ME KARAKTER PASUROR

Neni 14
Subjektet

1. Dispozitat e këtij kreu do të zbatohen për:
 - a) Për subjektet e përmendura në nenin 5;
 - b) Për personat fizikë dhe juridikë të njoftuar nga Komiteti i Sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, ose një organ tjetër kompetent ndërkombëtar, për të urdhëruar ngritjen e fondeve ose burimeve ekonomike, kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar se fondet ose burimet mund të shpërndahen, fshihen ose përdoren për financimin e organizatave ose aktiviteteve terroriste, përfshirë ato ndërkombëtare.
2. Masat e parandalimit me karakter pasuror mund të zbatohen edhe ndaj subjekteve, të cilat mund të lehtësojnë, në çdo mënyrë, me veprimet ose mosveprimet e tyre, subjektet që marrin pjesë aktive në akte dhune me rastin ose për shkak të ngjarjeve sportive.
3. Sekuestrimet e kryera gjatë operacioneve policore që synojnë parandalimin e manifestimeve të lartpërmendura të dhunës janë të vlefshme në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 15
Autoriteti propozues/iniciues

1. Për subjektet e nenit 14, masat parandaluese me karakter pasuror mund të iniciohen/propozohen/merren dhe dërgohen para Gjykatës së vendbanimit, apo selisë qendrore përrastet e personave juridikë, nga Policia e Shtetit (drejtoria Anti-terroror dhe TF) dhe Prokuroria.

Neni 16
Zbatimi i masave me karakter pasuror

1. Masat e parandalimit personal dhe pasuror mund të aplikohen dhe të zbatohen veçmas dhe në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Neni 17
Hetimet pasurore

1. Ndaj pasurive të subjekteve sipas nenit 14, mund të procedohet hetimi nga Policia e Shtetit dhe BKH mbi standardin e jetesës për të cilin ka dyshime se nuk justifikohet nga të ardhura të ligjshme, por nga veprimtari të aktiviteteve të krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit, me qëllim identifikimin e burimit të të ardhurave.
2. Ndaj subjekteve të cilët janë posedues licencash apo autonizimesh, subjekte të regjistruar në regjistrat profesional dhe publik, nëse përfitojnë nga kontributet dhe fondet publike prokurime PPP apo kredi të subvencionuara.
3. Hetimet do të kenë objekt edhe bashkëshortin, fëmijët dhe bashkëjetuesin e 5-viteve të fundit, si dhe ndaj të gjithë personave juridikë me të cilët pasuria e subjekteve të hetimit ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

4. Për të gjithë subjektet e hetimit sipas këtij kreu, Policia e Shtetit mund të kryej hetime dhe të kërkoj vënien në dispozicion të çdo informacioni dhe dokumenti që vlerësohet i dobishëm për qëllimet e hetimit, nga të gjitha institucionet publike dhe private pa përjashtim.
5. Për qëllime të hetimit sipas pikës 4 të këtij neni, të gjitha institucionet publike dhe private që ushtrojnë veprimtari në territorin e RSh-së, do të sigurojnë strukturave të Policisë së Shtetit:
 - a. Akses për strukturat e policisë në kompanitë telefonike për identifikimin në kohë reale të subjektit/numrit të telefonit apo lokalizimin e antenave loguese të dy komunikuesve, si dhe krijimi i mundësive të identifikimit të përdoruesit fundor të internetit.
 - b. Akses për strukturat e policisë në *data base* e regjistra elektronikë të institucioneve shtetërore dhe subjekteve private.
6. Në varësi të autonizimit të Prokurorit/Gjykatës oficerët e Policisë së Shtetit mund të procedojnë me sekuestrimin e çdo prove/dokumenti sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 18 Sekuestrimi

1. Policia e Shtetit mund të urdhërojë masën e sekuestros për çdo aset ose pasuri, që disponohet, administrohet apo është në pronësi të subjekteve nën hetim sipas neni 17 të këtij ligji, masë e cila duhet të vlefësohet nga Prokuroria brenda 48 orëve.
2. Gjykata e Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve (nga marrja e masës apo vlefësimi) duhet të shprehë me vendim mbi masën e sekuestros së pasurive për të cilat subjektet e këtij kreu, nuk arrijnë të provojnë burimin e ligjshëm me të cilin është krijuar apo fituar, apo kur vlera e tyre nuk është në përpjesëtim me të ardhurat apo fitimet e deklaruara të aktivitetit ekonomik.
3. Nëse Gjykata vlerëson se provat e paraqitura për vënien e masës së sekuestros nuk janë të mjaftueshme i cakton një afat të arsyeshëm organit propozues për plotësimin e tyre.
4. Gjykata revokon masën e sekuestros kur subjekti hetues arrin të provojë të ardhura të ligjshme për pasurinë që disponojnë, kanë krijuar apo fituar.
5. Asetet e sekuestruara me vendim Gjykate administrohen nga organi që ka propozuar masën e sekuestros.
6. Vendimi i vendosjes, refuzimit apo revokimit të sekuestros i komunikohet subjektit të hetimit dhe organit propozues të masës së kërkuar.

Neni 19 Ekzekutimi i sekuestros

1. Policia e Shtetit pasi i ka bërë me dije subjekteve nën hetim urdhrin e sekuestros dhe ka kryer formalitetet e nevojshme, vijon me posedimin, ruajtjen dhe administrimin e çdo aseti apo pasurie të sekuestruar deri në vlefësimin e urdhrin të sekuestros.
2. Bazuar në rrethanat dhe informacionet mbi hetimin Policia e Shtetit mund të urdhërojë evakuimin e ndërtesave të cilat janë objekt i masës së sekuestros.
3. Gjendja e sekuestros sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni ka efekt deri në vlefësimin ose jo të urdhrin të sekuestros nga Prokuroria/Gjykata.

Neni 20
Masat e sekuestros në kushtet e emergjencës

1. Kur ka dyshime se asetet ose pasuritë objekt hetimi i këtij kreu kanë rrezik të shpërndahen, vidhen ose tjetërsohen Gjykata e Shkallës së Parë, me kërkesë të organit propozues duhet të shprehet me vendim për vlefësimin e urdhit të sekuestros brenda 5 ditëve. (Kodi Antiterrorizmi parashikon një vendim vlefësimi të dytë nga Gjykata brenda 30 diteve gjë që do të ishte e tepërt në këtë ligj sa kohë që afati i vlefësimi përfundimtar do të jetë 15 ditë)

Neni 21
Të drejtat e personave të tretë

1. Personat e tretë të cilët rezultojnë pronar ose bashkëpronar të aseteve ose pasurive të sekuestruara, den në 30 ditë pas vendimit të sekuestros thirren nga Gjykata të ndërhyjnë në proces për të shprehur qendrimin dhe pretendimet e tyre në lidhje me masën e sekuestros;
2. Personat e tretë mund të përfaqësohen në proces nga një mbrojtës ligjor dhe duhet të provojnë se titulli i tyre i pronësisë nuk është fituar nga implikacione apo si mjedhojë e kontaktit të papërshtatshëm me grupet e krimi të organizuar apo terroriste;
3. Gjykata vendos heqjen e urdhit të sekuestros të plotë ose për pjesën takuese, në rastet e bashkëpronësisë, të personave të tretë nëse këta të fundit arrijnë të provojnë para Gjykatës sipas parashikimit të pikës 2 të këtij neni;
4. Dispozitat e këtij neni vlejnë edhe për personat e tretë të cilët gëzojnë të drejta reale ose të drejta të garantimit të aseteve apo pasurive të sekuestruara.

Neni 22
Konfiskimi

1. Gjykata vendos për konfiskimin e aseteve apo pasurive të cilat administrohen, posedohen ose janë në pronësi të subjekteve të këtij ligji, të cilët nuk kanë mundur dot të provojnë para Gjykatës origjinën e ligjshme të burimit me të cilin i kanë krijuar ose fituar asetet apo pasuritë objekt i gjyqimit.
2. Në asnjë rrethanë subjektet e këtij ligji nuk mund të përdorin si argument apo provë se të ardhurat për krijimin apo fitimin e aseteve dhe pasurive objekt hetimi, janë burim i evazionit fiskal;
3. Kur Gjykata vendos për konfiskimin e një asemi apo pasurie të caktuar, ajo do të vendosë edhe për konfiskimin e cdo të mirë materiale, asemi apo pasurie tjetër që është krijuar, fituar apo shumëfishuar me burim objektet ose të ardhurta nga aktiviteti i objekteve të konfiskimit;
4. Gjykata duhet të shprehet me vendim për konfiskimin e aseteve apo pasurive të sekuestruara, brenda 6 muajve nga dita kur vendimi për sekuestrimin ka marrë formë të prerë;
5. Në rastin e hetimeve komplekse, me vendim të arsyetuar Gjykata mund të urdhërojë zgjatjen e hetimit edhe me 6 muaj;
6. Nëse Gjykata nuk shprehet me vendim për konfiskimin e aseteve apo pasurive të sekuestruara sipas afateve të parashikuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni, urdhi i sekuestros e humb fuqinë e tij.
7. Afate pezullimi për tu vlerësuar nëse do të parashikohen në këtë ligj!

8. Vendimi i Gjykatës për revokimin ose shfuqizimin e masës së sekuestros nga jepet nga e njëjta Gjykatë që ka vlefësuar masën e sekuestros.

Neni 23 Regjistrimet fiktive

1. Kur organet që iniciojnë dhe kryejnë hetimet konstatojnë se asetet ose pasuritë objekt i hetimit janë regjistruar, tjetërsuar ose transfenuar në mënyrë fiktive tek personat e tretë me vendimin e konfiskimit Gjykata shpall edhe pavlefshmërinë e aktit të regjistrimit, tjetërsimit apo transferimit të objekteve të hetimit dhe të drejtave reale mbi to;
2. Për qëllime të pikës 1 të kësaj dispozite, denisa të vërtëtohet e kundërta, do të supozohet se janë fiktive dhe:
 - a) transferimi dhe fitimi i cdo titulli pronësie përgjatë dy viteve të fundit nga paraardhësit, pasardhësit, bashkëshortit, bashkejetuesit si dhe të afërmeve deri në shkallën e katërt;
 - b) transferimi dhe fitimi i cdo titulli pronësie, pa pagese ose të kryer në mirëbesim nga subjektet e këtij ligji.

Neni 24 Ankimimet

1. Vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë sipas neneve 18 dhe 22 të këtij ligji mund të ankimohen nga subjekti nën hetim apo organi i cili ka propozuar vendosjen e masës së sekuestros ose konfiskimit, nga dita e marrjes dijeni prej tyre pranë Gjykatës së Apelit, e cila duhet të shprehet me vendim të formës së prerë brenda 15 ditëve për masën e sekuestros dhe brenda 6 muajve për masën e konfiskimit;
2. Gjykata e Apelit duhet të disponojë me vendim lënien në fuqi, pezullimin, shfuqizimin ose refuzimin e vendosjes së masës së sekuestros ose konfiskimit, nëse nuk është vendosur më parë nga Gjykata e Shkallës së Parë;
3. Vendimi përfundimtar i vendosjes ose refuzimit të sekuestros dhe konfiskimit i komunikohet subjektit të hetimit, organit propozues të masës së kërkuar dhe Agjencisë së Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara;
4. Kur Gjykata e Apelit urdhëron për pezullimin ose shfuqizimin e vendosjes së masës së sekuestros dhe konfiskimit, në dispozitiv do të sanksionojë se ky vendim do të bëhet i zbatueshëm 10 ditë pas komunikimit të palëve;

Neni 25 Vendimi i revokimit

1. Revokimi i vendimit përfundimtar të konfiskimit mund të kërkohet nga organi propozues i masës së konfiskimit ose subjektet e këtij ligji në rastet kur:
 - a) janë zbuluar prova të reja të cilat mund të kishin qenë vendimtare nëse do të ishin administruar në gjykimin e vendosjes së masës ose refuzimit të saj;
 - b) kur faktet dhe provat e reja përjashtojnë absolutisht ekzistencën e kushteve për aplikimin e konfiskimit;
 - c) kur vendimi përfundimtar mbi vendosjen e masës ose refuzimin e saj, provohet se është marrë mbi prova të pavërteta ose të falsifikuara.

Neni 26

Raporti me procedimin penal

1. Të gjitha veprimet, hetimet dhe masat parandaluese me karakter pasuror iniciohen dhe zhvillohen në mënyrë të pavarur nga fillimi ose jo, vazhdimi apo përfundimi i ndonjë procedimi penal ndaj subjekteve të këtij ligji.
2. Asetet ose pasuritë mbi të cilat janë vendosur masat parandaluese të sekuestrimit dhe konfiskimit parashikuar në këtë ligj mund të bashkohen dhe administrohen nga i njëjti kujdestar së bashku me asete ose pasuri objekt sekuestro ose konfiskimi për shkak të një hetimi ose gjykimi penal, me autorizimin e Gjykatës që ka vendosur për masën parandaluese;

Neni 27

Masat parandaluese me karakter pasuror të ndryshme nga sekuestrimi/konfiskimi

1. Garancia pasurore;
2. Ngrirja e depozitave;
3. Administrimi dhe kontrolli gjyqësor i ndërmarjeve;
4. Trajtimi me përparësi i procedurave nga autoritetet shtetërore sipas këtij neni.
5. Kur ekzekutimi i masës parandaluese ka pushuar ose kërkesa është refuzuar, Gjykata vendos me kthimin e depozitës ose lëshimin e garancisë.
6. Masat paraprake të kapitalit të parashikuara në këtë nen ruajnë efektivitetin e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së masës parandaluese dhe nuk mund të revokohen, madje pjesërisht, përveç për nevojat e dëshmuara serioze personale ose familjare.

Neni 28

Administrimi menaxhimi dhe destinacioni i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara

1. Emërimi dhe revokimi i administratorit gjyqësor;
2. Përgjegjësitë e administratorit;
3. Shkaqet e papajtueshmërisë së administratorit;
4. Mbikqyrja;
5. Raportimi i administratorit para Gjykatës;

Neni 29

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara

1. Deri në një vendim përfundimtar të lëshuar nga Gjykata e Apelit, Agjencia do të kryejë veprimtarinë ndihmëse dhe mbështetëse për autoritetet gjyqësore duke i propozuar gjykatës gjithashtu miratimin e të gjitha masave të nevojshme për përdorimin më të mirë të aseteve ose pasurive në funksion të destinacionit të tyre.
2. Agjencia do të njoftohet për masat e modifikimit ose revokimit e konfiskimit, ato për autorizimin për të kryer akte të jashtëzakonshme administrative dhe të dhënat, të identifikuar me rregulloren zbatuese;
3. Agjencia mban komunikimet elektronike me autoritetin gjyqësor përmes sistemit të vet të informacionit, duke azhurnuar të dhënat e nevojshme.

4. Me vendimin përfundimtar të konfiskimit të lëshuar në Gjykata e Apelit, administrimi i pasurive i kalohet Agjencisë, e cila kujdeset për menaxhimin e tyre deri në lëshimin e vendimit të destinacionit.
5. Agjencia, brenda një muaji nga njoftimi për vendimin përfundimtar të konfiskimit nga Gjykata e Apelit boton në faqen e saj të internetit listën aseteve dhe pasurive të patundshme që i nënshtrohen konfiskimit, me qëllim lehtësimin e kërkesës për përdorim nga palët e interesuara;
6. Agjencia publikon marrëveshjet me autoritetet gjyqësore për të siguruar, përmes kriterëve të transparencës, rotacionin e detyrave të drejtorëve, korrespondencën midis profileve profesionale dhe pasurive të sekuestruara, si dhe deklarimin e shpërblimeve të fituara, të përcaktuara me udhëzim të përbshkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Drejtësisë. (Sipas kodit anti-mafia ka një dualitet midis autoriteteve gjyqësore dhe ekzekutive mbi administrimin e pasurive të konfiskuara, duhet një vendim marrje e grupit të punës nëse do të ndiqet ky model);
7. Avokati i Shtetit duhet të marrë përsipër përfaqësimin dhe mbrojtjen e administratorit gjyqësor apo të agjencisë në mosmarrëveshje me objekt administrimin e pasurive të konfiskuara. Kodi anti-mafia parashikon miratimin e një rregulloreje të veçantë për administrimin dhe destinacionin e pasurive dhe fryteve të aseteve/pasurive të konfiskuara, të drejtat e të treta, regjimi fiskal, përcaktimi i radhës së shlyerjeve të detyrimeve, mitja e fitimit, likuidimi, falimenti etj).

Neni 30

Destinacioni i aseteve dhe pasurive të konfiskuara me vendim përfundimtar

1. Të gjitha banesat dhe ambientet private për të cilat do të ketë një vendim përfundimtar konfiskimi sepse nuk justifikohen nga burime të ligjshme ose janë krijuar ose fituar nga burime të aktivitetit të krimit të organizuar, krimeve të rënda apo terrorizmi do të prishen, për aq kohë sa natyra e ndërtimit dhe struktura e tyre arkitektonike e lejon prishjen pa passjell dëme në pasuri të tjera;
2. Caktimi i destinacionit të pasurive të patundshme, aktiveve të korporatave dhe shoqërive tregtare do të kryhet me vendim të posacëm të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë (për diskutim përberja) bazuar në vlerësimin e fundit që i është bërë kapitalit të shoqërisë tregtare, korporatës apo çdo lloj subjekti juridik objekt konfiskimi.
 2. Agjencia do të miratojë me vendim parashikimin e destinacionit brenda nëntëdhjetë ditëve nga marrja e komunikimit të përmendur në nenin 24, pika 3, i cili mund të zgjatet për nëntëdhjetë ditë të tjera në rastin e çështjeve veçanësisht komplekse.
3. Agjencia do të pagujë Fondit të Drejtësisë (për diskutim kush institucion do ta administrojë) vetëm:
 - a) shumat e konfiskuara të parave që nuk duhet të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara ose që nuk duhet të përdoren për kompensimin e viktimave të krimeve objekt i këtij ligji;
 - b) shumat e marra nga shitja e pasurive të luajtshme të konfiskuara, përfshirë letrat me vlerë dhe aksionet e ndërmanjeve,
 - c) shumat që mjedhin nga rikuperimi i kredive personale.
4. Agjencia paguan 3 përqind të shumave të përgjithshme të përmendura më sipër për dhënie e bursave, për fëmijët e familjeve në nevojë.
5. Dispozita e pikës 4 nuk vlen për shumat e parave dhe për të ardhurat që mjedhin nga ose në çdo rast janë të lidhura me pasuritë e kompanisë së konfiskuar.
6. Pasuritë e paluajtshme që nuk kategorizohen në banesa private do të:

a) të kalojnë në pronësi të shtetit për qëllime të drejtësisë, rendit publik dhe mbrojtjes civile dhe, kur është e përshatshme, edhe për përdorime të tjera qeveritare ose publike të lidhura me kryerjen e veprimtarive institucionale të administratave shtetërore, agjencive tatimore, universitetet shtetërore, organet publike dhe institucionet përkatëse kulturore interesat, përveç nëse shitja e tyre duhet të bëhet për të kompensuar viktimat e krimeve objekt i këtij ligji;

b) do të mirëmbahen dhe përdoren nga Agjencia për qëllime ekonomike në varësi të autorizimit të Ministrit të Brendshëm (i Financave?);

c) transferohen për qëllime institucionale, ekonomike ose sociale, me detyrimin për të shfrytëzuar të ardhurat për qëllime sociale, në bashkisë ku ndodhet pronë. Autoritetet lokale duhet të hartojnë një listë të veçantë të pasurive të konfiskuara të transferuara tek ata, e cila azhurohet në mënyrë periodike çdo muaj. Lista, e bërë publike në faqen zyrtare të internetit të institucionit, duhet të përmbajë të dhënat në lidhje me konsistencën, destinacionin dhe përdorimin e pasurive, si dhe, në rastin e caktimit të palëve të treta, të dhënat e identifikimit të koncesionarit dhe detajet, objektin dhe kohëzgjatja e aktit të koncesionit. Mospublikimi i listës do të passjell përgjegjësi administrative për titullarin e autoritetit. Autoritetet lokale mund të administrojnë drejtpërdrejt pronën ose, në bazë të një marrëveshje të posaçme, ta japin atë me koncesion, pa pagesë dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe barazisë, për komunitetet terapeutike dhe qendrat për shërimin dhe trajtimin e personave të varur nga droga, apo dhe shoqatave të mbrojtjes së mjedisit. Marrëveshja koncesionare duhet të rregullojë kohëzgjatjen, përdorimin e aktivitetit, format e kontrollit të përdorimit të tij, arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies dhe format e rinovimit. Pasuritë që nuk janë caktuar të përdoren nga autoritetet lokale për qëllime të fitimit dhe të ardhurat e lidhura duhet të ripërdoren ekskluzivisht për qëllime sociale. Nëse brenda dy vitesh organi lokal nuk ka parashikuar caktimin ose përdorimin e pasurisë, Agjencia do të urdherojë heqjen e transferimit ose emërimin e një komisioni me fuqi zëvendësuese. Në fund të vitit Kryetari i Bashkisë do të dërgojë Drejtorit të Agjencisë një raport mbi statusin e procedurës. Destinacioni, caktimi dhe përdorimi i pasurive, si dhe ripërdorimi për qëllime sociale i të ardhurave që rrjedhin nga përdorimi ekonomik, duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë. Agjencia revokon destinacionin e aktivitetit nëse njësia marrëse ose marrësi nuk transmeton të dhënat në pënvendje të kërkuar.

7. Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të përmendura në nenin 6, germa b) pasi të zbriten shpenzimet administrative në fund të çdo viti do të derdhen në llogarinë e Fondit të Drejtësisë dhe në vitin pasardhës fiskal do të rialokohen për buxhetin e Ministrisë së Brendshme me objekt përdorimi forcimur e Agjencisë, duke përdorur një pjesë që nuk kalon 30 përqind të vlerës totale, për të mirur kapacitetet menaxheriale efektivitetin dhe efikasitetin e veprimit të Agjencisë. Masa e kuotës vjetore për shpërblime të stafit të Agjencisë bëhet me vendim të përbashkët të të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave me propozimin e Agjencisë dhe nuk mund të jetë më e lartë se 15 përqindja e fondit total.

8. Pasuritë e përmendura në nenin 6, për të cilat nuk është e mundur të bëhet destinacioni ose transferimi për qëllime të interesit publik të parashikuar në të, do të shiten me vendim të Agjencisë në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës civile. Njoftimi për shitje publikohet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë dhe njoftimi për botim jepet në faqen zyrtare të internetit të Kadastrës Shtetërore. Vlera e çmimit të shitjes bëhet në përputhje me çmimin e vlerësimit të pronës bazuar në vlerat e tregut. Nëse, brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e publikimit të njoftimit të shitjes, nuk merren asnjë ofertë blerëse çmimi minimal i shitjes nuk mund të përcaktohet në më pak se 80 përqind të vlerës së vlerësimit të lartpërmendur. Pa çenuar dispozitat e paragrafëve 9 dhe 10 të këtij neni, shitja i bëhet ofertuesit më të lartë, me përjashtimin e propozimit të subjektit që ishte pronar në kohën e miratimit të masës penale ose parandaluese, subjekteve të këtij

ligji si dhe bashkëshortëve, të afërm dhe të afërm brenda shkallës së tretë, si dhe personat që bashkëtojnë me ta. Agjencia përvetëson, në mënyrën e përmendur në nenet vijuese të këtij ligji, informacionin kundër krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit, në mënyrë që asetet dhe pasuritë objekt i këtij neni të mos blihen, madje edhe përmes një pale të tretë, nga persona të përgjashuar si më sipër ose duke përdorur të ardhura të një natyre të paligjshme. Pasuritë e paluajtshme të blera nuk mund të shitën, madje edhe pjesërisht, për pesë vjet nga data e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe ato Pasuritë e paluajtshme me një vlerë mbi 400,000 Euro shitën sipas procedurave të përcaktuara nga një rregullim i vecantë.

9. Mund të kenë të drejtën e parablerjes:
 - a) entitetet juridike me përbërje nga personeli nga forcat e armatosura ose forcat e policisë;
 - b) organet publike që kanë, ndër qëllime të tjera institucionale, gjithashtu atë të investimeve në sektorin e pasurive të patundshme;
 - c) shoqatat tregtare që sigurojnë, në projektin specifik, garanci dhe përfitime më të mëdha për ndjekjen e interesit publik;
 - d) fondacionet bankare;
 - e) autoritetet lokale.
10. Parablerja duhet të ushtrohet, në respekt të gjithë procedurave të parashikuara më sipër dhe nëse oferta më e mirë e marrë nuk është konsideruar me interes.
11. Të mirat materiale që derivojnë nga shitja e pjesës takuese të personave të tret në pronat e konfiskuara, nëse nuk tërhiqen nga pronari brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi i ftesës për t'u tërhequr do të disponohen nga Agjencia;
12. Gjykata duhet të vlerësojë pjesëtimin e pasurisë për pronat objekt i nenit 11.
13. Në rast të blerjes së pronave nga shteti shpenzimet gjuqësore sipas pikës 12 mbulohen nga Fondi i Drejtësisë;
14. Pasuritë e shoqërive juridike mbahen në asetet shtetit dhe destinohen, me vendim të Agjencisë për:
 - a) qira dhënien, kur ekzistojnë perspektiva të arsyeshme për vazhdimin ose rifillimin e veprimtarisë tregtare, të ndërmarrjeve dhe kompanive publike ose private, ose në hua, pa pagesa ndaj shtetit, ndaj kooperativave të punonjësve të kompanisë së konfiskuar. Në zgjedhjen e qiramarrësit ose huamarrësit, preferohen zgjedhjet që garantojnë mirëmbajtjen e niveleve të punësimit. Pasuritë nuk mund të ndahen me qira dhe hua për kooperativat e punonjësve të ndërmarrjes së konfiskuar nëse njëri prej ortakëve të afërm është një i afërm, bashkëshort, i ngjashëm ose bashkëjeton me marrësin e konfiskimit, ose subjekt i këtij ligji;
 - b) shitje, për një tarifë jo më të vogël se ajo e përcaktuar nga vlerësimi i bërë nga Agjencia, për subjektet që e kanë kërkuar atë, nëse ka një mjet më të madh për interesin publik ose nëse vetë shitja ka për qëllim kompensimin e viktimave të krimeve objekt i këtij ligji;
 - c) likuidimin, nëse ka mjete më të mëdha për interesin publik ose nëse vetë likuidimi ka për qëllim kompensimin e viktimave të krimeve objekt i këtij ligji si në shkronjën b);
15. Pasuritë e shoqërive juridike të përmendura në pikën 14, në rastin e pronave që i përkasin ndërmarrjeve të pasurive të patundshme, gjithashtu mund të transferohen, për qëllime institucionale ose sociale, në përputhje me pikën 6 shkronja c) si asete të bashkisë kur pasuria është me vendndodhje brenda juridiksionit të Bashkisë, nëse ky destinacion nuk paragjykon vazhdimin e biznesit ose të drejtat e kreditorëve të vetë kompanisë. Me udhëzim të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Ministrit të Brendshëm dhe atij të Drejtësisë, dhe me kërkesë të Agjencisë përcaktohen format e transferimit të pronësisë, në mënyrë që të sigurohet një përdorim efikas i aseteve të lartpërmendura, pa çenuar qëllimet të cilave të ardhurat përkatëse janë destinuar dhe pa pagesa të reja ose më të mëdha të financave publike.

16. Shoqëtitë juridike mbahen në asetet e shtetit pa rezultuar barrë ekonomike apo financiare, deri me kryerjen nga Agjencia të të gjitha rregullimeve dhe procedurave për transferimin e tyre për qëllime institucionale tek organet ose shoqatat e identifikuar sipas parashikimeve në dispozitat më sipër.
17. Të ardhurat që rrjedhin nga qiraja, shitja ose likuidimi i pasurive të përmendura në pikën 14 derdhen në Fondin e Drejtësisë të Vetëm për tu rialokuar vitin pasardhës fiskal, në masën e dyzet përqind për Ministrinë e Brendshme, me qëllim përdorimi mbrojtjen e sigurisë publike dhe ndihmës publike, dhe në në masën prej dyzet përqind Ministrisë së Drejtësisë, për të siguruar funksionimin dhe forcimin e zyra ve gjyqësore dhe shërbimeve të tjera institucionale, dhe, në masën e njëzet përqind të Agjencisë, për të siguruar zhvillimin e veprimtarive të saj institucionale, në përputhje me objektivat e stabilitetit të financave publike.
18. Pasuritë e luajtshme, madje të regjistruara në regjistrat publik, mund të përdoren nga Agjencia për t'u përdorur në veprimtari institucionale ose të destinuara për organet e tjera të shtetit, organet territoriale ose subjektet e parashikuara në pikën 6, letra c).
- Shërbimi Kombëtar e Zjarrfikeses do të ketë përparësi për kamionët, automjetet e punës, makinat operative, kamionët e ngjitjes së prumit dhe çdo mjet tjetër për përdorim të veçantë, funksional për nevojat e shpëtimit publik.
 - Pasuritë e luajtshme, përfshirë ato të regjistruara në regjistrat publik, të cilat nuk janë destinuar për qëllime të paragrafeve më sipër, mund të destinohen për shitje.
19. Për destinacionin e pasurive të patundshme të konfiskuara tashmë pjesë e aseteve të kompanisë së kompanive, aksionet e së cilës janë konfiskuar plotësisht ose të cilat janë në çdo rast të tilla për të siguruar kontrollin e kompanisë, zbatohen dispozitat e pikës 6 të këtij neni. Në rastin e shitjes së pasurive të kompanisë, zbatohen dispozitat e përcaktuara në pikën 8 të këtij neni. Pasuritë e përmendura në pikën 8 të cilat mbeten të pasitura, pas tre vjetësh nga fillimi i procedurës përkatëse, ruhen nën asetet e shtetit nga Agjencia. Menaxhimi i saj i besohet Agjencisë së Pronave Shtetërore.
20. Me vendim të të Ministrat të Drejtësisë, Ministrat të Ekonomisë dhe Financave, Ministrat të Brendshëm dhe Ministrat të Mbrojtjes, do të miratohet një rregullore për mbledhjen e të dhënave në lidhje me pronën e sekuestruar ose të konfiskuar, të dhëna që do të përfshijnë statusin e procedurës së sekuestrimit ose konfiskimit dhe të dhënat në lidhje me konsistencën, destinacionin dhe përdorimin e pasurisë së konfiskuar, si dhe transmetimin e të njëjtave të dhëna në Agjenci. Qeveria do të dërgoj një raport në Parlament çdo gjashtë muaj në lidhje me të dhënat e lartpërmendura.

Neni 31

Efektet e masave parandaluese me karakter pasuror

- Subjektet ndaj të cilave është kërkuar dhe vendosur një masë parandaluese me karakter pasuror janë të përjashtuar nga:
 - licencat dhe autorizimet që lëshon Policia e Shtetit;
 - koncesionet, kontratat dhe shërbimet publike në çdo sektor; kërkohen për ushtrimin e veprimtarive afariste;
 - çdo lloj funksioni në administratën publike;
 - certifikata të kualifikimit për të kryer punë;
 - subvencione apo kredi të subvencionuara;

Neni 32

Rehabilitimi/parashkrimi i efekteve të masave parandaluese

1. Pas tre vjetësh nga përfundimi i masës së parandalimit personal, pala e interesuar mund të kërkojë rehabilitim. Rehabilitimi jepet, nëse subjekti ka dhënë prova të vazhdueshme dhe efektive të sjelljes së mirë, nga gjykata e apelit në rrethun e të cilit ndodhet autoriteti gjyqësor që ka zbatimin e masës parandaluese ose masën e fundit parandaluese;
2. Rehabilitimi përfshin ndërprerjen e të gjitha efekteve paragjyqëse të lidhura me gjendjen e një personi që i nënshtrohet masave parandaluese si dhe ndërprerjen e ndalimeve të parashikuara nga ky ligj;
3. Dispozitat e kodit të procedurës penale do të aplikohen në lidhje me rehabilitimin/parashkrimin e masave parandaluese.

Neni 33

Përgjimet telefonike

1. Strukturat e Policisë së Shtetit do të kryejnë përgjim parandalues të telekomunikimeve, kur prej tyre administrohen indicie për kryerje të veprave penale që parashikohen në objektin e këtij ligji;
2. Autorizimi jepet nga drejtuesi i prokurorisë mbi bazën e kërkesës së bërë nga struktura e policisë
3. Procedura standarde e punës për përgatitjen e kërkesës për këtë lloj përgjimi përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
4. Përgjimet e autorizuara sipas këtij neni mund të përdoren ekskluzivisht vetëm për qëllimet dhe vazhdimin e gjurmimit (hetimit) dhe nuk kanë vlerë si provë gjyqësore.
5. Të gjitha përgjimet duhet ti përcillen Prokurorit i cili ka autorizuar veprimet e përgjimit, dhe gëzon të drejtën e asgjësimit të tyre, qoftë edhe pjesor.

Neni 34

Regjistri i masave parandaluese

KREU IV

BAZA E TË DHËNAVE KOMUNIKIMET INFILTRIMET

KREU V

VEPRIMET GJURMUESE POLICORE

Neni 35

Autorizimet e procedurat e zbatimit të masave të veçanta

Neni 35

Përgjimet parandaluese ambientale

1. **Strukturat e Policisë së Shtetit do të kryejnë përgjime ambientale në ambiente private me autorizim të drejtuesit të Prokurorisë përkatëse.**
2. **Strukturat e Policisë së Shtetit do të kryejnë përgjime ambientale në vende publike me miratim të drejtuesit të strukturës vendore të policisë dhe kur çështja ndiqet nga strukturat qendrore miratimi jepet nga drejtuesi i strukturës përkatëse qendrore të policisë.**
3. **Procedurat standarde të punës për realizimin e këtyre përgjimeve përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.**

Neni 36

Përdorimi i pajisjeve të lokalizimit

1. **Strukturat e Policisë së Shtetit kryejnë veprime për lokalizimin e vendndodhjes së personave të dyshuar për krim të organizuar, akt terrorist apo krim tjetër të rëndë, që cenon sigurinë publike, me kërkesë të strukturave vendore të policisë dhe me miratim të Drejtorit të Policisë Kriminale**
2. **Procedurat standarde të punës për kryerjen e lokalizimit nëpërmjet përdorimit të pajisjeve speciale miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.**

Neni 37

Ushtrimi i kontrolleve

1. **Strukturat e Policisë së Shtetit kryejnë me iniciativë kontrollime për parandalimin e akteve terroriste, parandalimin e kryerjes së krimit të organizuar apo të një krimi të rëndë në mjedise publike të hapura, me iniciativë nga një punonjës policie me gradën nënkomisar e lart.**
2. **Në ndërtesa apo objekte të tjera shtetërore e private, me iniciativë nga një punonjës policie me gradën nënkomisar e lart.**
3. **Në banesa private me autorizim të prokurorit.**
4. **Procedurat standarde të punës për kryerjen e këtyre kontrollimeve përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.**

Neni 38

Vëzhgimet sekrete

1. **Strukturat e Policisë së Shtetit kryejnë vëzhgime sekrete të subjekteve të veprave penale të parashikuara në këtë ligj, fizikisht dhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve optike, filmime, fotografime e pajisje të tjera teknike**
2. **Vëzhgimet sekrete autorizohen nga drejtuesi i strukturës vendore të policisë si dhe strukturat qendrore të policisë kriminale.**
3. **Procedurat standarde të punës për kryerjen e vëzhgimeve sekrete miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.**

Neni 39

Të drejta të veçanta të Policisë së Shtetit

1. Strukturat e policisë Kriminale kërkojnë informacion për parandalimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda në gjithë personat fizike e juridike.
2. Personat juridikë që ofrojnë rrjete, shërbime të komunikimeve elektronike dhe kompanitë e telefonisë celulare janë të detyruar t'i japin Policisë së Shtetit, me kërkesë të saj, çdo informacion të nevojshëm për të pëmbushur detyrat funksionale për parandalimin, zbulimin, identifikimin, dokumentimin me qëllim goditjen e organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, sipas këtij ligji.
3. Organet shtetërore apo entet publike, subjektet private janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave për informacion, të dhëna dhe dokumente, të dërguara nga policia e Shtetit brenda 10 ditëve kalendare. Në raste urgjente, policia mund të kërkojë informacion edhe brenda një afati më të shkurtër sesa ai i parashikuar në këtë nen.
4. Policia e Shtetit për parandalimin, zbulimin, identifikimin, dokumentimin me qëllim goditjen dhe shpërbërjen e organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, mer akses të drejtpërdrejtë në sistemet e teknologjisë së informacionit apo bazat e të dhënave të administruar nga institucionet publike, subjektet private, si dhe në çdo lloj regjistri publik, lidhur me të dhënat për gjendjen gjyqësore, regjistrin e gjendjes civile, të dhënat për pasaportat dhe dokumentet e tjera të identifikimit, të dhënat për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të çdo lloji, regjistra të përqendruar të dhënash për kontrata dhe/ose detyrime të subjekteve private me organe të shtetit, regjistrat noteriale, regjistrin e pronarëve përfitues, regjistrin e llogarive bankare, të dhënat mbi automjetet dhe lejet e drejtimit, të dhënat tatimore dhe doganore, të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale. Institucionet apo subjektet që disponojnë këto të dhëna janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të japin aksesin e kërkuar në informacion.
Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Policia e Shtetit administron e përdor për nevoja të përmirësimit teknologjik, kushteve të punës dhe shpërbërimit të punonjësve që kanë ndihmuar në zbulimin e veprave penale të parashikuara në këtë ligj, shumën e parave keshi dhe 60% të vlerës së aseteve të sekuestruara e konfiskuara.

KREU VI

Strukturat Përgjegjëse dhe kontrolli i ligjshmërisë

Neni 40

Strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit

1. Për efekt të zbatimit të këtij ligji në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit do të ngrihet një strukturë e posaçme e quajtur Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar, në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, e cila së bashku me Drejtorinë e Antiterrorit do të jenë dy strukturat përgjegjëse për zbatimin e çdo dispozite që ngarkon Policinë e Shtetit në këtë ligj.
2. Të dyja strukturat e mësipërme do të ushtrojnë funksionet e tyre në një godinë të përbashkët e të posaçme vetëmnë funksion të pëmbushjes së detyrave që derivojnë nga ky ligj.
3. Në varësi të drejtpërdrejtë të tyre, në 12 drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit, do të ngrihen drejtoritë rajonale kundër krimit të organizuar dhe antiterrorit.

4. Dy drejtoritë në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit do të asistohen nga përfaqësues të institucioneve të treta që ngarkon me zbatim ligj si edhe nga ekspertë të fushës të organizatave dhe agjencive partnere të huaja ligzbatuese.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të dy drejtorive do të jenë mbledhja e informacioneve, përditësimi, përpunimi i të dhënave dhe kryerja e çdo veprimi administrativ, procedural e hetimor që parashkohet në dispozitat e për subjektet e këtij ligji.
6. Struktura, përbërja dhe pagat me të cilat do të trajtohen punonjësit e Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar dhe Antiterroit do të përcaktohen me akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 41

Kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga policia

1. Gjatë gjithë veprimtarisë së strukturave të Drejtorisë së Krimin Kundër Krimin të Organizuar dhe Drejtorisë së Antiterroit, në zbatim të këtij ligji, ato do të monitorohen kontrollohen nga strukturat eprore hierarkike për ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve dhe moskalim të kompetencave.
2. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme e Ankesave në Ministrinë e Brendshme ushtron kontrole të vazhdueshme periodike dhe të jashtëzakonshme lidhur me zbatimin korrekt të ligjit nga strukturat përgjegjëse të policisë dhe specialistët operues.
3. Prokuroria ushtron kontroll për zbatimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga strukturat policore për zbatimin e masave parandaluese.

Neni 42

Shpërdorimi dhe abuzimi me informacion dhe kompetencën

1. Kryerja e veprimeve joligjore, abuzuese dhe në kalim të kompetencave në zbatimin e masave të përcaktuara në këtë ligj nga punonjësit e policisë përbën veprë penale.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.